



KONKURS PËR APLIKIMIN E STUDENTËVE PËR PJESËMARRJE NË

KLINIKËN LIGJORE PËR MBROJTJEN NDËRKOMBËTARE – AZILI, REFUGJATËT DHE PASHTETËSIA

Fakulteti Juridik i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan në bashkëpunim me Programin për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK) e financuar nga UNHCR organizon Klinikën Ligjore për Mbrojtjen Ndërkombëtare – Azili, Refugjatët dhe Pashtetësia.

Klinika Ligjore për Mbrojtjen Ndërkombëtare do të mbahet nga data 18/03/2025 deri më 17/04/2025 në hapësirat e Universitetit Publik "Kadri Zeka". Gjate Klinikës pesë-javore, do të zhvillohen ligjërata mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare, simulime të rasteve, diskutime të vazhdueshme si dhe do të organizohet një vizitë në Qendrën e Azilit. Studentët do të angazhohen në ushtrime me role praktike për të zbatuar procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit dhe pa-shtetësisë në skenarë të ndryshëm.

Klinika Ligjore ka për qëllim të ofrojë njohuri mbi Ligjin Ndërkombëtarë për Refugjatët, me theks të veçantë parimin e Mos-kthimit, procedurat për përcaktimin e statusit të refugjatit dhe pa-shtetësisë, duke përfshirë procedurën administrative dhe gjyqësore lidhur me kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare.

Studentëve, paraprakisht do t'ju ofrohen materialet e nevojshme për lexim si dhe certifikatat e pjesëmarrjes pas përfundimit të klinikës.

Kushtet për aplikim:

1. Student aktiv në vitin e III apo e të IV akademik në Fakultetin Juridik;
2. Nota mesatare mbi 7 (shtatë);
3. Preferohet njohja e gjuhës angleze;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. CV;
2. Dëshmi për statusin e studentit të rregullt / Vërtetimi studentor;
3. Certifikata e notave për qëllime të brendshme.

Aplikimi bëhet në Zyrën për projekte, Znj. Egzona Rexhepi, U.D. Udhëheqëse e Projekteve nga ora 09:00 – 15:00, deri më datën 14/03/2025, ora 16:00.

Studentët e përzgjedhur do të njoftohen më së largu deri më 17/03/2025.

Klinika Ligjore pesë-javore do të fillojë punimet me datën 18/03/2025.



Funded by
the European Union

EU REGIONAL SUPPORT TO
PROTECTION-SENSITIVE
MIGRATION MANAGEMENT SYSTEMS
IN THE WESTERN BALKANS

